

Letërnjoftimi i Komunës së

SKENDERAJT

2014

Maj, 2015




Fakte

- Të hyrat buxhetore të komunës së Skenderajt më 2014 kanë shënuar rënie prej 100 mijë euro në krahasim me një vit më parë.
- Në administratë komunale janë të punësuar 192 persona, apo një shërbyes civil për 267 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Skenderaj ka edhe së paku 5 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudha mbi një vjeçare.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 987 persona, prej tyre 709 mësimdhënës. Në Komunën e Skenderajt raporti nxënës/mësimdhënës është 37.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 216 persona. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Skenderajt është 237.8. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Skenderaj gjatë vitit 2014 ka pasur 5,477 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Skenderaj rreth 10.6% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 189 biznese të reja. Për dallim nga viti paraprak, tani shohim një zvogëlim të numrit të bizneseve, që do të thotë se kemi 102 biznese më pak se sa në vitin 2011.
- Gjatë vitit 2014, janë shuar 39 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Gjatë fushatës zgjedhore Kryetari i Skenderajt z. Sami Lushtaku ka qenë në paraburgim. Partia në emër të tij ka 19 premtime madhore të cilat kemi arritur ti monitorojmë. Deri në maj 2015 janë realizuar 21% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%. Gjatë tërë mandatit të dalë pas zgjedhjeve lokale të 2013, Komuna e Skenderajt nuk është udhëhequr asnjë ditë nga kryetari për shkak të paraburgimit. Z.Lushtaku është dënua nga gjykata e shkallës së parë në fund të majit 2015 me 12 vjet burg.

2 Qeverisja komunale


Komuna e Skenderajt në zgjedhjet e fundit lokale (2013) përsëri i besoj qeverisjen komunale Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Kryetari aktual i Skenderajt z.Sami Lushtaku (PDK) ka fituar mandatin në raundin e parë zgjedhor. Ajnishahe Halimi (VV) ishte kandidatja e dytë më e votuar në Skenderaj me gjithsej 1,145 vota. Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 23,513 apo rreth 40.25% qytetarë me të drejtë vote.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave në raundin e parë



Zgjedhjet për Kuvend Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 26 ulëse, kurse LDK, AAK, AKR, VV dhe PD me nga një ulëse.

Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Skenderajt në bazë të zgjedhjeve 2013




Ekzekutivi komunal i Skenderajt ka 11 drejtori.

3 Buxheti i Komunës së Skenderajt


Më 2014, Komuna e Skenderajt kishte buxhet prej 11.9 milion eurove, një zvogëlim prej afro 60 mijë euro në krahasim me vitin 2013. Buxheti për investime kapitale është mbi 3 milion euro, një rritje në krahasim me dy vitet paraprake.

Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Skenderajt dhe kategoritë kryesore buxhetore




Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Skenderajt ishin afro 1.6 milion euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje në krahasim me vitin 2013.

Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Skenderajt 2011-2015




Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë ku kemi një rritje të lehtë nga viti paraprak.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komunitat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Skenderajt ka arritur të mbledh shumë më pak të hyra nga tatimi në pronë sesa komunitat si Vitia, Suhareka, Malisheva, Drenasi, etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, riparimi i veturave, kanë shënuar rënie në krahasim me një vit më parë, ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore




Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Skenderaj e ka përmbyllur me 1.395 të punësuar në sektorin publik. Përgjatë këtij viti, janë punësuar 23 shërbyes civil më shumë në sektorin e shëndetësisë dhe 12 punonjës në sektorin e arsimit.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Skenderajt



Skenderaj ka të punësuar një shërbyes civil për 267 banorë. Në krahasim me komunitat tjera, Skenderaj ka më shumë të punësuar në administratën lokale, në krahasim me popullsinë që ka. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Skenderaj ka edhe së paku 5 të punësuar me kontratë mbi vepër. Këta të punësuar me kontratë mbi vepër janë të angazhuar për periudhë mbi një vjeçare.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 987 persona, prej tyre 709 mësimdhënës. Në Komunën e Skenderajt raporti nxënës/mësimdhënës është 37.1. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9. Edhe në sektorin e arsimit Skenderaj ka të punësuar më pak staf se sa mesatarja në shkallë vendi.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Skenderajt



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 216 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Skenderajt është 237.8. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale


Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 189 biznese të reja, që do të thotë se kemi një rënie prej 102 biznese më pak që nga viti 2011. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.

Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Gjatë vitit 2014, janë shuar 39 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



Në përgjithësi, Skenderaj radhitet ndër komunat me probleme të mëdha ekonomike, për shkak të papunësisë së lartë dhe ambientit jo të favorshëm të të bërit biznes.

6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna gjatë fushatës zgjedhore. Gjatë fushatës zgjedhore Kryetari i Skenderajt z. Sami Lushtaku ka qenë në paraburgim. Partia në emër të tij ka 19 premtime madhore të cilat kemi arritur ti monitorojmë. Deri në maj 2015 janë realizuar 21% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%. Gjatë tërë mandatit të dalë pas zgjedhjeve lokale të 2013, Komuna e Skenderajt nuk është udhëhequr asnjë ditë nga kryetari për shkak të paraburgimit. Z.Lushtaku është dënuar nga gjykata e shkallës së parë në fund të majit 2015 me 12 vjet burg.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

